

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 30.06.2025, në orën 12:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Qershor 2025, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga zv/kryetari z. Agostin Marku, i cili lexoi rendin e ditës si dhe një projektvendim shtesë.

-Agostin Marku: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen. Meqenëse shumica e këshilltarëve janë të pranishëm, mbledhjen e deklaroj të hapur. Mbledhja zhvillohet sipas rendit të ditës, që është njoftuar për çdo këshilltar, por edhe për bashkinë edhe për institucionin e Prefektit.

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Maj 2025”
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. D.D. për djegie banese”
3. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. J.G. për djegie banese”
4. Projekt-Vendim “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e parë të vitit 2025”
6. Projekt-Vendim “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e hapjes së rrugës së lagjes Butem dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë T&J Construction shpk për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë”
9. Projekt-Vendim “Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Komunës San Demetro Corone, Itali”
10. Informacion nga Bashkia Lezhë mbi zbatimin e buxhetit për 5-mujorin e vitit 2025
11. Informacion nga Bashkia Lezhë për masat e marra për sezonin turistik 2025
12. Të ndryshme

Në pikën dymbëdhjetë ka ardhur një projekt vendim dhe të ndryshmet kalojnë më poshtë, një projekt-vendim i cili ka të bëjë me miratimin e azhurnimit të hartës përfundimtare të plazheve të lejuara, vendbazimeve ujore dhe zonave e shërbimeve në vijën bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2025, projekt-vendim i cili u është vënë në dispozicion të gjithë këshilltarëve, por është trajtuar edhe në mbledhjet e komisioneve përkatëse gjatë kohës që janë zhvilluar mbledhjet e komisioneve. Në pjesën dërmuese, mbledhjet e komisioneve janë zhvilluar gjatë ditës së premte, pra s'kemi ndonjë ngërç apo ndonjë problematikë.

Në këto kushte, kush është dakord për miratimin e rendit të ditës me aq sa deklarova më sipër?

Miratohet me 25 vota pro, këshilltari Emanuel Perjaku nuk votoi. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Maj 2025”

Kush e do fjalën nga komisioni apo nga bashkia, ka ndonjë problematikë për këtë projekt-vendim, ndonjë shtesë, ndonjë sugjerim, diçka? S'ka. Nga këshilltarët, ka ndonjë mendim, sugjerim, diskutim? S'ka.

Kush është dakord? Me të gjitha votat pro miratohet, 26 vota Pro.

Kalojmë në pikën e dytë, Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. D.D. për djegie banese”

Komisioni ka ndonjë diçka? Po, zoti Pjetër, kryetari i komisionit.

-Pjetër Noka: Komisioni është mbledhur dhe i ka miratuar të dy familjet që janë. Jemi dakord.

-Agostin Marku: Tjetër? Tek relacioni, shikoni, keni një lapsus më duket, për rastin e parë, ku thoni propozojmë që masa e kompensimit për dëmin e shkaktuar për orendi, duhet të shtoni edhe pjesën përqindjen për banesën, se del sikur është dhënë e gjitha shuma për atë, besoj se është lapsus, por te p/vendimi jam në rregull.

Ka kush ndonjë vërejtje, ndonjë problem, ndonjë diçka tjetër?

Atëherë kush është dakord për këtë projekt-vendim për zotin D. D.? Miratohet me të gjitha votat pro, 26 vota Pro.

Kalojmë te projekt-vendimi tre, u shpreh për të dy projekt-vendimet kryetari i komisionit, Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të emergjencave, dhënie ndihme financiare z. J.G. për djegie banese”

Kush ka ndonjë diçka të veçantë për këtë projekt-vendim? S'ka.

Kush është dakord, kundra, abstenim? Miratohet me të gjitha votat pro, 26 vota Pro.

Kalojmë te pika 4, Projekt-Vendim “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”.

Pra, janë projekt-vendime që kanë të bëjnë me banesa të cilat janë që në vitet '90, çështje procedurash administrative dhe asgjë tjetër më shumë. Kush ka ndonjë vërejtje apo ndonjë problem për këtë? Pra duhet të kalojë në këshill që i zoti të marrë hipotekën.

Kush është dakord, kundra, abstenim? Me të gjitha votat pro miratohet, 26 vota Pro.

Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, pika 5, Projekt-Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e parë të vitit 2025”

Një projekt-vendim që ka të bëjë me shifrat e buxhetit, me të ardhurat dhe shpenzimet faktike për 4-mujorin e parë, të cilat janë të rakorduara edhe me thesarin, është shtruar edhe në komisionin e financës, s'ka ndonjë problematikë, nuk e di nga komisionet e tjera, nuk e di nga këshilltarët ka ndonjë diçka të veçantë, apo nga vetë drejtoritë përkatëse, drejtoria e taksave, tarifave vendore dhe drejtoria e financës, në qoftë se ka ndonjë shtesë, ndonjë diçka të na thonë apo ka ndonjë sugjerim.

Kush e do fjalën? Po Donika.

-Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve. Në fakt shifrat flasin vetë për një rënie drastike të të ardhurave dhe shpenzimeve. Një pyetje kisha unë në lidhje me këtë, me se lidhet ky mosrealizim i të ardhurave dhe

tatimeve në këtë periudhë katër mujore që flasim, pasi normal se kjo bie peshë mbi qytetarët, marrin më pak shërbime, më pak investime në lidhje me ta dhe si e parashikoni ecurinë për katër mujorin e dytë, domethënë do të vazhdoni me realizim të mbledhjes së këtyre të ardhurave apo me se lidhet kjo mosrealizim i mbledhjes së të ardhurave për katër mujorin e parë, të ardhurat dhe shpenzimet që janë realizuar më së pakti, më pak se plani në të dy rastet edhe të ardhurat edhe shpenzimet më pak se plani me përqindje goxha të konsideruar, faleminderit.

-Agostin Marku: Tjetër pyetje ju lutem, ka pyetje të tjera që të përgjigjet zëvendëskryetarja njëkohësisht për të gjitha? Ka ndonjë pyetje? S'ka. Fjala për ju.

-Brikena Vuksani: Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, në bazë të monitorimit të buxhetit për katër mujorin e parë, sipas analizës që është bërë, realizimi i të ardhurave vendore është në masën 25.7%, ndërsa i shpenzimeve është 37.5%, po nuk është se mund të flasim për një ulje drastike të të ardhurave ashtu siç ju e thatë, në fakt është për një mosrealizim i cili ka disa faktorë, nga planifikimi i të ardhurave që ne kemi bërë nga buxheti që kemi miratuar vjet buxhetin në muajin dhjetor, sot, nga janari deri në muajin prill, për të cilët bëhet raportimi, ka disa mangësi në realizimin e të ardhurave, kryesisht për arsye të përmirësimit të sistemit të taksave, ne kemi punuar pas miratimit të paketës fiskale vitin e kaluar deri muajt e parë të këtij viti, kemi punuar për përmirësimin e sistemit, kemi azhurnuar të gjitha të dhënat, kryesisht edhe për bizneset, por edhe për familjarët, gjë të cilën nuk e kishim pasur të mundur një vit më përpara, që do të thotë që pas katër mujorit të parë, pesë mujorit dhe tani në qershor do të kemi një realizim të të ardhurave dhe do të shikojmë dhe raportin e qershorit pastaj kur të dalë që realizimi ka kaluar pritshmëritë dhe është aty ku duhet, e njëjta gjë vlen edhe për shpenzimet për arsye se po të shikojmë realizimin e shpenzimeve katër mujorin e parë kryesisht janë vetëm për shpenzimet për paga, pak më pak janë për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime për arsye të fillimit të hapjes së procedurave të buxhetit, planifikimit, për arsye të regjistrimit të prokurimeve, miratimit të procedurave të prokurimit, që nuk mund të bëhen që muajt e parë kryesisht, por që janë në proces dhe pastaj pas muajit qershor do fillojnë edhe me likuidimet përkatëse ose me shpenzimet.

-Doli këshilltari Zek Doda.

-Agostin Marku: Mirë, Faleminderit, Besoj s'ka kush tjetër diskutim,

Atëherë kush është dakord?

Miratohet me 21 vota Pro. Këshilltarët Emanuel Perjaku, Donika Ndoj, Donika Haxhia votuan Kundër. Këshilltarja Alfrida Marku nuk mori pjesë në votim.

-Erdhi këshilltari Zek Doda.

-Agostin Marku: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, pika 6, Projekt-Vendim “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)”

Është një projekt-vendim që ka kaluar të gjitha fazat e diskutimit edhe në dëgjuesën publike, ka kaluar edhe në komisione, s'ka pasë ndonjë diçka të qënësishme për të ndryshuar, në qoftë se në këto dëgjuesat publike ka dikush ndonjë diçka që duhet marrë në konsideratë edhe nga propozimet që mund të jenë bërë, urdhëro thuajini dhe ta diskutojmë dhe kalojmë pastaj në miratim.

Atëherë një prezantim të shkurtër nga zëvendëskryetarja e bashkisë,

-Brikena Vuksani: Kemi paraqitur projekt-vendimin për miratimin fazës së parë për projektbuxhetin për vitet 2026-2028. Faza e parë është një instrument kyç i planifikimit dhe menaxhimit të financave të bashkisë, është faza e parë strategjike, ne kemi filluar që nga muaji janar dhe përfundon në muajin qershor. Kemi filluar në janar me parashikimin e vlerësimit të ardhurave të cilat janë miratuar po këtu në këshill, gjithashtu dhe me miratimin e prioriteteve në bazë të diskutimeve që janë bërë edhe me ju këshilltarët edhe me banorët edhe me drejtoritë përkatëse në bazë të planifikimeve që kanë bërë. Ky projekt-dokument është hartuar në përputhje me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë si dhe me udhëzimet përkatëse nga Ministria e Financave. Vjen duke marrë një analizë të planifikimit që ne kemi bërë, është në përputhje me situatën financiare që kemi pasur një vit më përpara ku kemi realizuar të ardhurat në masën 92.6%, ndërsa shpenzimet në masën 80%. Pra flasim për një stabilitet financiar të Bashkisë Lezhë edhe një parashikim realist të të ardhurave, planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për tre vitet që vijnë, gjithashtu kryesisht planifikimet kryesore të investimeve që janë në infrastrukturën rrugore apo në infrastrukturën për lulishtet apo për shërbime të tjera që t'u ofrojmë qytetarëve, për të ardhurat, e rëndësishme është që të themi që 54.9% janë me burimet e veta, nga të ardhurat e veta, ndërsa pjesa tjetër janë nga transferta e pakushtëzuar që është 26.5% dhe transferta sektoriale 14.9%. Mund të themi që nga të ardhurat nga viti 2026 në vitin 2027 kemi parashikuar një ulje të të ardhurave se besoj se mund ta keni vënë re, është për shkak të tarifës për 3% nga banesat sociale. Pastaj nga viti 2027 në vitin 2028 kemi një rritje të të ardhurave me 0.8%. Për sa i përket planifikimit sipas llogarive ekonomike mund të themi që për pagat kemi me transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e bashkisë, kemi 30%, ndërsa për investimet shkojnë deri në vlerën 39% të shpenzimeve gjithsej. Një gjë tjetër të cilën ne hasim vështirësi dhe tani do vazhdojë dhe faza e dytë që është nga muaji korrik deri në muajin shtator që është edhe faza teknike ku të gjitha këto kërkesa që kemi bërë në fazën e parë do të konkludohen akoma më shumë, të rishikohen edhe të jemi sa më afër parashikimeve, do të kisha kërkuar bashkëpunimin tuaj në lidhje me dëgjuesat publike që të kemi sa më shumë pjesëmarrjen tuaj edhe në bazë të kërkesave të banorëve ose të qytetarëve që ju mund t'i adresoni pranë bashkisë, kaq kisha, faleminderit.

-Agostin Marku: Mirë, faleminderit, kush e do fjalën, atëherë Flutura.

-Brikena Vuksani: Edhe diçka tjetër. Keni marrë edhe mendimet e Ministrisë së Financave në lidhje me përgatitjen e fazës së parë për buxhetin që është brenda afateve, është brenda çdo lloj standarti. Mund të them që Bashkia e Lezhës është model në përgatitjen e PBA-së dhe bashkitë e tjera marrin mendime nga Bashkia Lezhë.

-Agostin Marku: Faleminderit për kujtesën. Këshilltarët mund të diskutojnë edhe rreth këtij materiali që ka ardhë nga Ministria e Financave, njëkohësisht me këtë, materiali që ka ardhë nga Ministria e Financave nuk është për vendimmarrje, por ta ezaurojmë në këtë pikë.

-Flutura Gjoni: Materiali nga Ministria e Financave veç ju kishte duartrokitur.

-Brikena Vuksani: Është për t'u duartrokitur në fakt se është ndër të paktat bashki që arrijnë ta bëjnë. Të shtoj diçka mëqë kam të gjitha drejtoritë këtu, dua t'i falenderoj për gjithë punën e palodhur që bëjnë

sepse buxheti nga janari deri në dhjetor nuk mbaron dhe kjo fazë ka qenë në kohë rekord për të gjithë dhe është shumë më mirë se gjithë fazat e tjera që kemi kaluar.

-Agostin Marku: Unë dua t'i falenderoj drejtoritë sepse si asnjëherë tjetër janë të gjithë të pranishëm këtu dhe kështu duhet të jenë në të gjitha mbledhjet, fjala për ju Flutura.

-Flutura Gjoni: Atëherë në materialin që na keni dhënë aktivet e trupëzuara që janë artikull 231 kanë ardhë në shumë totale, në mënyrë analitike unë nuk i gjeta kund në materialin që kishim bashkëlidhur.

-Brikena Vuksani: Po gjithsesi është ajo që ne kemi miratuar në shkurt për miratim e prioriteteve.

-Donika Haxhia: Vetëm një pyetje kisha, duke parë shpenzimet sipas programit të planifikuar dhe të rishikuara 2025 dhe 2027 për arsimin dhe kulturën dhe përkujdesja sociale dhe strehimi ka një rënie shumë shumë të theksuar te planifikimi.

-Agostin Marku: Fjala për ju zëvendëskryetare.

-Brikena Vuksani: Për përkujdesjen sociale strehimin është për arsye se ne këtë vit në 2025-ën kemi parashikuar fondet për rindërtimin e pallatit 71 që është për strehimin social dhe po ta shikosh vitet e tjera ngaqë do marrë zgjidhje këtë vit edhe bie dhe planifikimi sepse ka peshën më të madhe tek programi social, strehimi social, rindërtimi i pallatit.

-Donika Haxhia: Nuk llogariten rastet e reja, familjet e reja.

-Brikena Vuksani: Po edhe në varësi të tarifës që ne do presim të marrim këtë vit sepse akoma nuk është në përfundim dhe do rishikohet edhe plani buxhetor në lidhje me këtë tarifë.

Dhe arsimit të njëjtën gjë për arsye se ne këtë vit në 2025-ën kemi pasur rekonstrukcionin e 39 kopshteve nëpër njësi administrative dhe rikonstrukcionin e shkollës "Gjergj Fishta" dhe kryesisht kanë pjesën më të madhe të buxhetit këtë vit në 2025 pastaj siç e thashë edhe nga rishikimet që mund të bëjmë gjatë fazës së dytë ne mund, edhe me mendimet tuaja të adresojmë problematika ose investime.

-Donika Haxhia: Po ngaqë kërkohen për shembull hapja e kopshteve të reja ose çerdheve dhe po të duket sikur s'merret parasysh fare.

-Brikena Vuksani: Jo, nuk është që nuk merret parasysh por për çerdhen ne kemi një projekt tani, po e studiojmë edhe do ta prezantojmë besoj shumë shpejt para këshillit.

-Agostin Marku: Frida më fal, ka një ndërhyrje specialisti i buxhetit për të sqaruar, fjala për ju Xhemal.

-Xhemal Haxhia: Në relacionin që është përgatitur që është bashkë me materialin, bashkë me pasqyrat, jepen shpenzimet në bazë të programeve, por edhe në bazë të fushave, mos ju referoni shumë programeve se programet buxhetore janë për efekt organizimi dhe funksionimi më të mirë të buxhetit, janë ato fusha që i përcaktojnë prioritetet e zhvillimit, keni një pasqyrë, një grafik të tillë dhe unë nuk i shoh këto shifra që reklamoj zonja këshilltare, duke iu referuar qoftë arsimit, qoftë mbrojtjes sociale, pothuaj ruajnë një trend për tre vitet e ardhshme, shihet raportin sipas fushave, shpenzimet sipas fushave, kanë prioritetet,

janë 10 fushat bazë mbi të cilat mbahet një shtet, bashkia financon nëntë fusha, kaq janë edhe funksione sipas ligjit.

-Agostin Marku: Fjala për ju Frida.

-Alfrida Marku: Faleminderit zoti nënkryetar i këshillit, para se të kaloj te tre çështje që dua t'i shtroj për diskutim, një përgjigje e thjeshtë në atë parantezën tuaj, unë përtej bindjeve apo edhe debateve politike, është një interes tjetër i madh dhe i patjetërsueshëm që më identifikon edhe besoj që bëj pjesë, interesi i qytetarëve të Lezhës, kështu që jam në rregull me përfaqësimin e problematikave, kuptohet, gjithsecili prej nesh do të bëjë më shumë, por përballë interesit qytetar, debatet politike duhen anashkaluar nga të gjithë.

Atëherë sa i përket programit buxhetor afatmesëm në fazën e parë që ju e keni paraqitë, ju e vutë theksin tek dëgjesat publike dhe tek ftesa që i bëtë anëtarëve të këshillit bashkiak për të dhënë kontributin e tyre në referimin e problematikave që gjithsecili prej nesh ka detyrim të identifikojë dhe të adresojë tek institucioni i Bashkisë. Unë me 25 shkurt të këtij viti me shkresë zyrtare jam drejtuar duke adresuar disa problematika të identifikuar nga komunikimi i përditshëm me qytetarë, të cilët në vlerësimin tim, por edhe në shqetësimin që qytetarët kanë, mendoj që duhet të përfshihen në buxhetin e vitit 2026 apo më së paku në programin buxhetor afatmesëm 2026-2028. Ndër të tjera në këtë shkresë zyrtare, të cilën ua kam drejtuar si këshillit ashtu edhe institucionit të bashkisë, kam referuar disa problematika konkrete.

Së pari, dhënia zgjidhje duke ndërtuar nga fillimi apo identifikuar një objekt dhe rikonstruktuar për ta përshtatur si çerdhe për fëmijët e qytetit të Lezhës, pra dhënia zgjidhje e mungesës së çerdheve në qytetin e Lezhës, këtu ju kujtoj që qyteti i Lezhës ka vetëm një çerdhe publike me kapacitet normal 70-80 fëmijë, mos gaboj, është përtej kapacitetit.

Së dyti, kam adresuar si problematikë që duhet të gjejë zgjidhje edhe me bashkëfinancim në harkun kohor të tre viteve, rikualifikimin e plotë të lagjes së Spitalit dhe të lagjes Skënderbeg, për të bërë të mundur zgjerimin e qytetit të Lezhës dhe për të shkuar tek ajo që ne shpesh i themi një qytet policentrik apo me disa qendra të zhvilluara, kjo do na jepte mundësinë që të heqim dorë nga mbingarkesa përtej arsyes me ndërtime në një zonë të kufizuar dhe ta zgjerojmë Lezhën në parametra bashkëkohorë.

Pikë tjetër, identifikimi dhe krijimi hapësirave të reja për parkimet publike në qytetin e Lezhës është një problem emergjent për të gjithë ne dhe vetëm zgjerimi i zonës urbane i jep zgjidhje.

Krijimi i hapësirave të reja të gjelbërta në qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin.

Një projekt për minimizimin e efekteve të erozionit në zonën bregdetare, në Shëngjin, Kune dhe në Vain, pra në kryesisht në zonën e Kunes dhe Vainit, kuptohet që kjo është një iniciativë që në aspektin financiar kërkon doemos bashkëfinancim me qeverinë apo bashkëpunim me fondet e Bashkimit Europian, është detyrë e bashkisë që ta adresojë në mënyrën e duhur.

Projekti një nxënës - një pemë, nëpërmjet të cilit të nisë mbjellja e pemëve në çdo njësi administrative.

Pra ne fokusin e kemi tek ndërtimet, tek resortet, i bëjmë një reklamë edhe të ekzagjeruar, mendoj unë, por kemi harruar që Lezha ka nevojë për hapësira të gjelbërta, Lezha ka nevojë për vende parkimi, Lezha ka nevojë për zgjerimin e zonës urbane, ndërtimin e bibliotekës publike në çdo njësi administrative, është

një mënyrë e mirë për edukimin në bazë të të rinjve, por një mënyrë mirë për të ndihmuar edhe gjithësecilin, gjithësecilën familje, ndërtimi i tregut industrial, një treg në një zonë tjetër, jo më aty, unë mendoj që e ka ekzauruar qëllimin e tij, zona tashmë ka marrë një trajtë që tregu në afërsi të shinave e mbingarkon, krijon një kaos, kështu që Bashkia Lezhë duhet të identifikojë një zonë tjetër për t'i hapur mundësi edhe zhvillimit sepse gjithmonë e kemi thënë aty ku është tregu edhe ka tendencën zona që të zhvillohet, rikualifikimi i njësive administrative, ofrimi i shërbimit të qendrave ditore në njësité administrative që kanë numrin më të lartë të banorëve, kuptohet pa harruar edhe investimet në bujqësi dhe në rrjetin rrugor.

Këto janë disa problematika që unë i kam adresuar mbi bazën e identifikimit me komunikimin e përditshëm me banorë, edhe pyetja ime tashmë është retorike, unë jo vetëm nuk i gjej të përmendura, por nuk i gjej aq më pak edhe të përfshira, të paktën këto nuk janë probleme anonime, këto janë probleme që qytetarët e Lezhës i shtrojnë edhe kërkojnë doemos zgjidhje, këto nuk janë problemet e një grupi të vogël njerëzish, por janë problemet e mijëra banorëve të Lezhës, pika e parë kjo, pika e dytë për të cilën, meqë jemi tek buxheti, pra para se të shkojmë tek 2026, unë do të doja që nga përfaqësuesit e bashkisë të kemi një relativitet saktë, zyrtar mbi fazën në të cilat është zbatimi i projekteve të miratuara në vitin 2025 edhe unë do e vija theksin tek rehabilitimi i rrugëve, tek ndërtimi varrezave të reja të qytetit, ju keni shkruar aty ndërtimi, por unë mendoj që ju keni parashikuar vetëm rikonstrukcion të kopshteve aktuale, pra kemi projektin për rikonstrukcionin e kopshteve, por akoma deri më sot deri në 2028-ën, siç është programi buxhetor afatmesëm, nuk kemi të parashikuar diçka konkrete për çerdhet, ku jemi me ndërtimin e qendrës ditore për moshën e tretë apo për rindërtimin pallatit në qendër të qytetit të dëmtuar nga tërmeti. Pra, përveç projekteve të tjera, unë vura theksin te këto që janë të domosdoshme, edhe unë kërkoj nga ana juaj që të kemi një relativitet të saktë se në çfarë faze jemi me zbatimin, së treti, në projektbuxhetin që ju keni paraqitur, ju u munduat ta sqaroni, por unë mendoj që duhet një sqarim më i saktë, krahasuar me parashikimet e të ardhurave për në 2025-ën, në 2026-ën dhe deri në 2028-ën kemi 4.2 miliardë lekë më pak të ardhura, kështu që cilat zëra buxhetorë parashikohen që kanë rënie apo ndoshta në raport sa i përket vitit 2025 kemi një parashikim jo realist që në fakt duhej anashkaluar sa i përket të ardhurave, pra kemi 4.2 miliardë lekë më pak të ardhura të parashikuara për 2026 sesa viti aktual buxhetor. Unë nuk mendoj se banesat sociale zënë një hapësirë prej 4.2 miliardë lekë në buxhet, faleminderit.

-Agostin Marku: Mirë, fjala për ju.

-Xhemal Haxhia: Tani është mirë me i lexu materialet që janë paraqitur, më fal se po them, në relacionin që është bashkëlidhur ky material përmbledhës i ke të sqaruar një për një, kush i jep efektin e uljes së të ardhurave në 2026-2028, besoj matematikë dinë të gjithë, në qoftë se kemi bërë gabim, tërhiqemi, kërkojmë falje, kaq del, janë 127 milionë.

Të lutem, Frida, ti do krahasosh planin me planin, jo planin e rishikuar. Në planin e rishikuar janë edhe që vijnë nga viti 2024. Të lutem, t'i shohim gjërat siç duhet me logjikën e ligjit, jo me interpretime. Planin e 2025-ës, krahasimin mos merr planin e rishikuar. Ke dy shifra për 2025, po pikërisht pra e ke të sqaruar në relacion, besoj që është shkruar në shqip.

-Agostin Marku: Tani kur aty thuhet plani i rishikuar dhe thuhet të mbartura dhe kemi marrë një vendim, ju lutem tani, se s'keni të drejtë vetëm ju, edhe kemi marrë një vendim për rishikimin, nuk ka të bëjë me planifikimin e të ardhurave ajo pjesë, se aty janë të gjitha tepricat e vitit 2024 që në thesar trashëgohen

dhe Flutura e di më mirë sesa unë, pra ndaji gjërat, në qoftë se ka një diçka, të lutem, në qoftë, po janë të shkruajtur aty, në qoftë se ka një diçka që ka zëra të të ardhurave që janë më të ulëta në 2026 se në kuotat e 2025, thoni specifikisht cilat dhe specialisti argumenton pse se edhe mund të ketë, si janë prioritetet, një merr prioritet, një zë për të ardhurat, një tjetër mund edhe të ketë problematika dhe bie. Fjala për ju, zëvendëskryetare.

-Brikena Vuksani: Po, përsa i përket përfshirjes në buxhet të kërkesës që bëri zonja këshilltare, ne i kemi diskutuar këto dhe tek miratimi i prioritetëve që kemi bërë në shkurt dhe këto kërkesa është afati ose momenti i duhur kur do të merren parasysh është tek faza e dytë, që është nga korriku deri në shtator, pasi në fazën kur ne kemi diskutuar është miratuar dhe tavanet edhe prioritet dhe të gjitha. Përsa i përket për investimit për çerdhe, unë e përmenda dhe pak më përpara, ne jemi drejt hartimit të një projekti për përshtatjen e një ambienti tjetër për çerdhen e qytetit.

Përsa i përket edhe për hapësirat për parkingje publike dhe për zonat e gjelbërta, gjithashtu jemi duke bërë studimin e zonave se ku do të bëjmë, domethënë me hartimin e projekteve që kemi ne planifikim këtë vit në buxhet, do të bëjmë projektet për të gjitha këto pika që folëm. Gjithashtu për projektet e vitit 2025, për rrugët rurale, një nga investimet që është e parashikuar në 2025-ën, ka përfunduar procedura, është lidhur kontrata, rrugët rurale kanë filluar, janë në proces, për ndërtimin e varrezave, sapo ka dalë VKM-ja që na jep ne të drejtën që të operojmë për tek zona e përcaktuar për ndërtimin varrezave, për ndërtimin e qendrës së moshës së tretë, jemi në proces të lidhjes së marrëveshjes me shoqatën që do bëjë donacionin, gjithashtu për investime të tjera që kemi është stacioni Mabë-Dragushë që do fillojë tani së shpejti, kemi investimet që janë për rikonstruksionin e 39 kopshteve në njësitë administrative që jemi në fazë prokurimi dhe së shpejti do fillojë rikonstruksioni i tyre, gjithashtu ka filluar edhe, është në proces mbyllje edhe procedura për shkollën, rikonstruksionin e shkollës Gjergj Fishta. Të gjitha investimet janë në proces të fillimit të mbarimit të procedurave dhe të fillimit të punës. Po ashtu së shpejti do të fillojnë edhe rehabilitimi i rrugëve urbane në qytet, pasi pas investimit të KFË-së do të bëjnë edhe rrugët urbane. Edhe për pallatin 71 presim Vendimin e Këshillit të Ministrave që të na japë ne autorizimin që të vazhdojmë me procedurat.

-Agostin Marku: Mirë, faleminderit, kush do fjalën tjetër? Atëherë kalojmë në votim. Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 22 vota Pro. Këshilltarët Emanuel Perjaku, Donika Haxhia, Donika Ndoj votuan Kundër. Këshilltarja Alfrida Marku votoi Abstenim.

Kalojmë në projektvendimin tjetër dhe konkretisht pika 7, Projekt-Vendim “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”

Kush ka ndonjë problem? S'ka. Dua të falenderoj bashkinë që mori në konsideratë dhe edhe vërejtjet dhe propozimet e këshilltarëve në mbledhjen e kaluar, pra numri i kësaj radhe është i konsiderueshëm, 23 vetë, tani te projektvendimi, shikoni se do të kenë harruar, por në fund duhet shkruajtur: ngarkohet kryetari i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Sepse s'ka marrë trajtën e projektvendimit të plotë. Me këto shtesa kush është dakord që ta miratojmë? Kundra? Abstenim? Pra ka të bëjë me kalimin e tokës bujqësore, çfarë kanë në përdorim shtetasit, në pronësi që vazhdojnë procedurat.

Miratohet me 25 vota Pro. Këshilltarja Donika Haxhia votoi Abstenim.

-Fatjon Zefi: A mund të bëj një sqarim?

-Agostin Marku: Dakord, bëjeni, po jo mbasi ta miratojmë, urdhëro zoti zëvendëskryetar.

-Fatjon Zefi: Thjesht për këtë pjesën e reagimit nga ana e bashkisë, nuk është se ka pasë mangësi nga bashkia, thjesht ato vijnë nga hipoteka dhe ne i miratojmë direkt, pra nuk është se i vonojmë, jemi të varur nga ASHK-ja.

-Agostin Marku: Nuk kishte vërejtje. Ishte çështja e sensibilizimit edhe nga këshilli, këshilli dhe bashkia kur bëjnë punë të mira janë një, kështu që mos e merrni si vërejtje.

Shumë mirë opinioni publik ka marrë në konsideratë të gjitha ato dhe kanë ardhur njerëzit është rrit ajo çështja e sensibilizimit, është gjë pozitive.

-Alfrida Marku: Ju mbledhjen e kaluar thatë që janë rreth 800 praktika. Pra, me këtë ritëm kur parashikohet të mbarojë.

-Agostin Marku: Atëherë zëvendëskryetari.

-Fatjon Zefi: Këto praktika ne i kemi dërguar të gjitha në ASHK, të 800 dhe ato trajtohen nga ASHK-ja dhe i bien pjesë pjesë, prandaj po them, nuk varet nga bashkia as nga këshilli bashkiak. Ne jemi në gatishmëri t'i sjellim t'i miratojmë.

-Agostin Marku: Mirë, kalojmë tek pika 8 e rendit të ditës, Projekt-Vendim "Për miratimin e hapjes së rrugës së lagjes Butem dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë T&J Construction shpk për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butem, fshati Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë"

Ka kush ndonjë diçka të veçantë, urdhëro zoti Pjetër.

- Doli këshilltari Tonin Jaku.

-Pjetër Tushaj: Meqënëse m'u dha mundësia atë ditë me qenë në atë konsultimin publik edhe me thënë të drejtën që të vijnë nga Kashnjeti, nga Ungrej këtu, të vijnë mbi 20-25 vetë, ishte e çuditshme. Edhe i pyetën banorët në atë konsultim publik edhe ishin të hapet një rrugë në një fshat atje që s'kishte pasë kurrë, rruga shumë mirë, edhe ata njerëzit që ishin, ishin të gjithë dakord për hapjen e rrugës edhe për pjesën e pyjores që inxhinieri na shpjegoi se këtu ka ndodhur një fakt tjetër që vijnë për konsultim publik 2-3 vetë nga një fshat edhe pastaj hapin gojën mbrapa edhe mua më bëri përshtypje edhe jashtëzakonisht mirë. Unë mendoj që edhe inxhinieri që ishte ua shpjegoi të gjitha gjërat edhe ishim të gjithë dakord edhe unë i ftoj të gjithë ta votojnë.

Kam një problem tjetër, unë e kam ngritur edhe një herë tjetër te këta shokët e bashkisë, është hapë ajo rruga nga Kunia për të liruar trafikun këtej, edhe unë meqënëse jam i atij profesioni edhe e njoh shumë mirë rregulloren e qarkullimit, nuk kisha pa në jetën time që të prishen tabelat e qarkullimit edhe të hyjnë kundravajtje njerëzit sot në 2025, në asnjë mënyrë nuk e kisha parë kurrë, as dëgjuar kurrë.

-Agostin Marku: Faleminderit. Kush ka për çështjen diçka tjetër?

Atëherë pra, siç e tha dhe Pjetri, të gjitha procedurat janë ndjekur edhe me dëgjuesën publike, me gjithçka tjetër, tani në shërbim të qytetarëve është ajo rrugë, diçka zëvendëskryetari, po.

-Fatjon Zefi: Kjo rrugë është e financuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë, pra do të investohet menjëherë pas dhënies të lejes së ndërtimit nga bashkia, prandaj ishim të detyruar që ta miratonim si rrugë që të pajiset edhe me lejen e ndërtimit.

-Agostin Marku: Kush është dakord për miratimin e këtij projektvendimi?

-Flutura Gjoni: Vetëm një gjë kisha.

-Agostin Marku: Si rregull kur hidhet në votim, mbyllen diskutimet, vazhdo Flutura,

-Flutura Gjoni: Kjo firma, shoëria, çfarë interesi ka që do me e ba këtë

-Agostin Marku: Fjala për zëvendëskryetarin, në përgjigje të shqetësimit të këshilltares, Flutura Gjoni.

-Fatjon Zefi: Siç e thashë, kjo rrugë është financuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë dhe këshilli i qarkut ka kontraktuar në tender kompaninë në fjalë, pra kompania nuk ka asnjë interes, thjesht është e detyruar që me bë këtë procedurën se ka prekë një fond pyjor, rruga prek një fond pyjor dhe është e detyruar që t'ia marrë me qera bashkisë, pra firma do paguajë, s'ka punë kompania, thjesht do bëjë punimet kompania, nuk ka asnjë interes tjetër.

-Agostin Marku: Atëherë kush është dakord, kundra, abstenim? Miratohet me të gjitha votat pro, 25 vota Pro.

-U largua këshilltari Emanuel Perjaku.

-Agostin Marku: Kalojmë tek pika 9 e rendit të ditës, Projekt-Vendim “Për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Lezhë, Shqipëri dhe Komunës San Demetro Corone, Itali”.

Komisioni e ka diskutuar. Këtu s'ka pasë ndonjë diçka esenciale, specialisti në komision tha dhe efektin e kësaj marrëveshjeje dhe përfitimet që ka bashkia, diçka keni të shkruajtur edhe në relacion, megjithatë kush e do fjalën, kush ka ndonjë paqartësi apo dhe nga vetë drejtoria përkatëse në bashki, në qoftë se ka ndonjë shtesë, është një projekt vendim që ka rëndësi të miratohet, sepse në fund të fundit sa më shumë kemi marrëveshje me njësi të tilla, sidomos në Itali që ka një përvojë të konsiderueshme në mënyrën e administrimit të pushtetit vendor, veç mirë është për Bashkinë e Lezhës.

Kush është dakord atëherë se e shoh se s'keni, pro, kundra, abstenim? Miratohet me të gjitha votat Pro, 24 vota Pro.

Kemi dy pika që janë informacione, por mendoj të mbarojmë edhe me një projekt vendim që kemi, të mbarojmë me projekt vendimet, pastaj kalojmë te këto informacionet.

Erdhi këshilltari Tonin Jaku.

-Agostin Marku: Projekt-vendim “Për miratimin e azhornimit të hartës përfundimtare të plazheve të lejuara, vendbazimeve ujore dhe zonave e shërbimeve në vijën bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2025“, është në kuadrin e një sërë vendimesh që ne kemi marrë, është në kuadrin e stabilizimit të kësaj çështjeje, edhe për problematikat që kanë dalë rrugës, merr vulën përfundimtare, unë

besoj edhe me sa kemi dëgjuar edhe opinionin publik, gjërat janë për mirë, edhe ajo pjesa skeptike e një pjese të opinionit publik se nuk do të funksionojë kjo për plazhet etj etj, po funksionon në fakt, dihet se gjithçka kur punohet ka dhe problematika, por e rëndësishme është që gjithçka po bëhet në shërbim të qytetarëve që të kenë mundësi të kalojnë një kohë sa më të mirë me plazhet publike. Ka kush ndonjë vërejtje, ndonjë shqetësim, ndonjë sugjerim përse i përket këtij projekt vendimi?

-Alfrida Marku: Për azhornimin të na sqarojnë.

-Agostin Marku: Po, e ke në formë pyetje, po, atëherë, kush e do fjalën për të sqaruar për këtë? Zoti zëvendëskryetar?

-Fatjon Zefi: Në lidhje me stacionet e plazheve, kanë ardhur miratime nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, kanë ardhë me vonesë dhe nuk kanë qenë në përputhje me hartën që kemi miratuar ne që e kemi dërguar dhe jemi detyruar të bëjmë disa azhornime për t'i përshtatë me numrin e çadrave që kanë miratuar ata, gjithashtu edhe nga dy subjekte, mos gaboj që kanë bërë kërkesë për vendbazime ujore, pra e kanë bërë me vonesë, jemi detyruar të shtojmë vendbazim për mjetet motorike.

-Agostin Marku: Po kush e do fjalën. Mikrofonin për specialistin, ju lutem.

-Behar Shpendi, D. Urbanistikës: Atëherë, në lidhje me azhornimin e hartave, kjo është harta përfundimtare, se janë azhornuar, janë të vendbazimet, janë pasqyruar në hartat, bashkangjitur projekt vendimit. Janë të përshkruara në relacion, te Rana e Hedhun, edhe në zonën e plazhit Shëngjin edhe korridor në plazhin e Tales, faleminderit.

-Agostin Marku: Ka kush ndonjë gjë tjetër? Kush është dakord me projektvendimin, ju lutem?

Miratohet me 23 vota Pro, Këshilltaret Donika Haxhia dhe Donika Ndoj votuan Abstenim.

Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, informacion nga Bashkia Lezhë mbi zbatimin e buxhetit për pesëmujorin e parë të vitit 2025, kush e do fjalën nga bashkia? Ndonjë gjë konkrete keni? S'keni. Nga anëtarët e këshillit ka ndonjë diçka për informacionin, ngaqë zëvendëskryetarja thotë, përmenda gjatë kohës kur demonstroam katër mujorin edhe shifrat e projektbuxhetit afatmesëm 2026-2028. S'ka ndonjë diçka tjetër?

Po, është pika tjetër, informacion nga Bashkia Lezhë për masat e marrë për sezonin turistik 2025, kush e do fjalën nga bashkia? Po zoti Ronaldo, fjala për ju.

-Renaldo Xhanej: Përshëndetje të gjithëve. Duke shikuar që bregdetet e Lezhës po kanë një cilësi shumë të mirë të turizmit edhe turistët me thënë të drejtën këtë vit kanë shikuar që Shëngjini ka bërë disa ndryshime dhe krejt vija bregdetare ka bërë disa ndryshime edhe jo kot po e vizitojnë edhe më shumë, ne shikojmë edhe shifra që janë më të larta, kjo për arsye se bashkia ka marrë disa masa, një ndër këto është ka ngritur një grup monitorimi që monitoron krejt vijën bregdetare. Monitoron perimetrat e sigurisë, monitoron shërbimin e pastrimit, monitoron hapësirat me dron në terren, se si operatorët turistikë i lirojnë hapësirat publike apo synojnë për të marrë ndoshta dhe për të shikuar që me të zënë territorin bashkia ky grup pune nuk e ka lënë me thënë të drejtën asnjë hapësirë publike që të zihet ose të uzurpohet. Ushtron kontroll inspektiv në krejt vijën bregdetare për të përmbushur kriteret e rregullores që është sipas VKM-së së plazheve, për mbajtjen e mjedisit të pastër, për mbajtjen e plazheve, janë marrë edhe 30 punonjës

me kontratë, është ngritur edhe ndërmarrja e menaxhimit të plazheve, Lezha Invest, për të menaxhuar plazhet nga Bashkia Lezhë, ku janë ngritur edhe disa zona që kanë çmime të veçanta të menaxhuara, me çmime të arsyeshme siç është Talja me 300 lekë apo edhe Shëngjini me 400 lekë apo edhe Rana e Hedhun me 500 lekë, krejt e arsyeshme për turistët. Kjo bën që edhe ata që ndoshta nuk kanë shumë mundësi ekonomike të krijojnë shërbimin e plazhit. Masa të tjera që janë marrë edhe për menaxhimin e mirë të bregdetit është edhe instalimi në Shëngjin i disa drejtorive si drejtorja e shërbimeve, drejtorja e turizmit, njësitë kryesore rrijnë çdo ditë në monitorim të hapësirës bregdetare edhe kjo për të shikuar cilësinë e turizmit, informimi i bizneseve për rregulloren e turizmit. Ne çdo vit, por edhe këtë vit kemi informuar të gjithë operatorët turistikë për rregulloren, për oraret kur hidhen mbetjet, për mënyrën se si do t'i lënë mbetjet pa ndotë edhe ambientin. Në orarin e caktuar vjen, merr kompania edhe turistët gjejnë një vend sa më të pastër, kështu që disa masa të tjera që janë marrë për një sezon turistik sa më cilësor janë edhe menaxhimi i trafikut në bashkëpunim me policinë e shtetit, ndalimi i mjeteve të rënda, fugonave me orare të caktuara, por edhe rivendosja e kamerave në Shëngjin, policia e shtetit ka nënstationin e policisë së Shëngjinit, janë të monitoruar, bën monitorimin e kamerave, janë rikthyer dhe njëherë kamerat në Shëngjin, për arsye se pati një stopim të tyre për një rast, dhe një tjetër që është masë e marrë është dhe instalimi i zjarrfikëses në Shëngjin, tani në sezonin veror instalohet në njësinë e Shëngjinit dhe monitoron krejt hapësirën e bregdetit, hotelerisë por edhe pyjeve që vjet për fatin e keq patëm një rast jo të mirë, kështu që edhe menaxhimi në bashkëpunim me instancat qendrore, me agjencinë e bregdetit, me operatorë të tjerë siç është fakti që tani janë hapur në Shëngjin edhe qendra verore për ambulanca verore, një tjetër hap është edhe në Tale, që i shërben turistëve shumë më mire.

Në 24 maj ne kemi hapur sezonin turistik ku pat një sy edhe për mediat.

Gjithashtu Bashkia Lezhë ka botuar guidën e re turistike që ne para dy ditësh realizuam edhe një panair në Deçan.

Të gjithë këto krijojnë një tablo që ne të krijojmë një sezon turistik, t'i thirrjmë turistët, në mënyrë që të vijnë në plazhet tona, sepse ofrojmë cilësi, ofrojmë kushte, bashkëpunimi me operatorët turistikë ka qenë shumë i mirë, edhe turistët po dalin të kënaqur ,faleminderit.

-Agostin Marku: Kush e do fjalën? Zoti Gjinkola.

-Pjeter Gjinkola: Tash unë kam një problem lidhur atë trafikun, ose më e saktë, me qenë shumë i saktë, unë pata kërku dhe dy mbledhje më pare, në takim edhe me kryetarin e bashkisë këtu, pata kërkuar që në vendet ku është hapësira në qytetin e Shëngjinit, pavarësisht se bjen rruga nacionale mes përmes qytetit të krijohet mundësia edhe për ne ku të lëmë makinat ne, se s'kemi ku me shku, tash në emër të turizmit e në emër të satelitëve a ku di unë se ça, kanë kurdis, janë lëshuar dhe kanë asgjësuar komplet parkimet në qendrën e Shëngjinit dhe janë kthyer në zona privilegje, me një fjalë, privilegj do të thotë se persona të caktuar i shfrytëzojnë demek, bëjnë demek se janë tu shku me i kontrollu, diçka që për mua më duket shumë e papërshtatshme, sepse rruga që është rrugë, është e rregullt, pjesa e parkimit nuk do ishte asgjësuar nga ky drejtori i shërbimeve bashkë me policinë bashkiake e ku unë kush i bën këto punë, sepse në shumë vende është 100% sigurtë, e mundshme rruga për me kalu me ndejt makinat e atyre rezidencialëve aty dhe këta kanë saju se demek se erdh turizmi tash dhe janë çu peshë hopa demek se ça jena tu ba ndërkohë kur 70% e rrugës së Shëngjinit që vijnë këta turistët e kanë rrugë edhe njëkalimshe me pret njëri-tjetrin ndërsa aty ku kemi hapësirën ne

-Agostin Marku: Pjetër të lutem të lutem sa më racional mos i përsërit

-Pjeter Gjinkola: Du me e sqaru në detaje

-Agostin Marku: Është e sqaruar çështja. Të lutem. Ke gjë tjetër?

-Pjeter Gjinkola: Ikyt kisha unë në raport me parkexhet.

-Agostin Marku: Faleminderit. Tani shqetësimi është shqetësim, do flasin edhe përfaqësuesit e bashkisë, por kjo s'do të thotë se mund të marrë zgjidhje sot, kjo kërkon një investim, kjo kërkon një studim, tani krahas shqetësimit që ngriti këshilltari Gjinkola, duhet që bashkia të marrë në konsideratë një diçka, me policinë bashkiake, me drejtorinë e shërbimeve dhe të gjitha ato segmente që i ka për mbarëmbajtjen e turizmit, në Shëngjin, Tale, Rana e Hedhun, të merren në konsideratë që mos të bëhen veprime duke krijuar hapësira për ato që tha edhe duke gjet hapësira për qytetarët rezidencialë, faleminderit.

Kush e do fjalën nga ju? Zëvendëskryetari, po

-Fatjon Zefi: një sqarim të shkurtër, dhënie të hapësirave publike për parking në Shëngjin nuk ka, në qoftë se ke dijeni mund të komunikosh me mua ose policisë bashkiake. E dyta, the janë zënë hapësirat publike për oborret e pallateve, nuk janë zënë.

Drejtori i shërbimeve publike ose i policisë bashkiake nuk etiketohen si persona privatë, paguhen nga Bashkia Lezhë për punën e tyre dhe ata zbatojnë vendimet e marra, nuk mund të thuash filani filani, personale, sikur më thonë mua për zënien e stacioneve të plazhit, që je ti Fatjon Zefi, je i fortë po na heq shezllonet aty, zbatimin e ligjit kanë për ta bërë.

-Agostin Marku: Kush e do fjalën tjetër, po Alfrida.

-Alfrida Marku: Disa problematika që më janë referuar nga qytetarët që përbëjnë shqetësim në zonën e Shëngjinit, e para, është ndotja akustike lokale apo disko verore të cilat kanë marrë leje, kuptohet nga institucionet përgjegjëse, përfshirë këtu edhe bashkinë, por që veprojnë në kushte tejet jo normale, edhe po marr rastin e zonës së Kunes e cila është zonë rezidenciale, ndotja akustike është kthyer në një shqetësim për familjarët e asaj zone, por ka ndikuar edhe tek pushuesit. Problem tjetër që kjo nuk i përket vetëm zonës së Kunes, kryesisht kësaj zone, por gjithë vijës bregdetare të Shëngjinit edhe të Tales, është dezinfektimi. Për disa vite me radhë nuk u krye si proces edhe këtë e dimë të gjithë. Këtë vit pati një iniciativë për nisjen e procesit të dezinfektimit, banorët dhe pushuesit kanë ankesa se në disa zona nuk është kryer, në disa zona të tjera nuk është kryer në nivelet e duhura, kështu që unë kërkoj nga ana e bashkisë, pavarësisht se kjo është kompetencë e një institucioni tjetër, por mbarëvajtja e sezonit turistik implikon të gjitha autoritetet, i kërkoj bashkisë që të adresojë dhe të kërkojë zgjidhje që dezinfektimi të jetë një proces që të kryhet siç duhet, pra të kryhet i plotë, pa e mohuar që ka nisë si procedurë, por në shumë vende nuk është kryer, në disa vende të tjera nuk është i plotë, pra ne si qëllim duhet të kemi dezinfektimin edhe jo vetëm reklamimin e nisjes së një procesi pa dashur me paragjyku askënd.

Tjetër është, unë e thashë edhe gjatë mbledhjes, erozioni. Bashkia duhet të marrë masa të adresojë në instancat e duhura qëndrore që t'i japë zgjidhje, sepse një vit pa zgjidhje janë metra rërë të mbuluara nga uji, pra pasojat e erozionit janë të përekuperueshme, edhe një pyetje problematikë tjetër që është edhe aktuale, a ka Bashkia Lezhë, a ka marrë masa për kapacitetet, kam pikëpyetje, në fakt, kjo është edhe

një problematikë që derivon edhe nga mungesa e vëmendjes në nivel qendror, për përballimin e zjarreve, sepse na është kthyer kjo situata e zjarreve në pyje gjatë verës, debat politik, edhe jo debat që me të vërtetë kërkon zgjidhjen në bazë, pra kemi disa deputetë që thonë e vunë zjarrin, disa të tjerë që thonë jo po keni e vu vetë zjarrin, pra disa deputetë nuk po japin zgjidhje, disa të tjerë po zgjohen nga zjarret, kështu që unë i kërkoj bashkisë që me autoritetin që ka ta adresojë që qeverisja qendrore ta asistojë dhe ta financojë Bashkinë e Lezhës në raport edhe me problemet evidente të zjarreve në pyje, sidomos gjatë kësaj periudhe. Faleminderit.

-Renaldo Xhanej: Kisha përgjigje për zonzjën, duke dalë edhe në pyetjen e parë që bëre, këtë vit për herë të parë, ne në bashkëpunim me instancat qendrore, policia e shtetit kryesisht, po monitoron ndotjet akustike për arsye se i kanë ardhur disa aparatura të reja policisë së shtetit, ku ne për çdo shqetësim, çdo lloj ankese, kemi bashkëpunuar me ta edhe kanë shkuar në kohë dhe kanë marrë edhe masa, sepse deri vjet shkonin dhe nuk kishin si me e matë zhurmën. Këtë vit kanë aparatura dhe po më tregojnë edhe nga intervista që bëjmë me operatorët turistikë, na tregojnë se janë më të qetë për arsye se ndotësit akustikë këtë vit sikur janë reduktuar pak. Sistemi dixhital nuk fal dhe duke përdorur këta matësas kanë bërë efikasitet. Duke dalë edhe te pyetja e dytë për dezinfektimin, vitet e para ka pasur problem tenderimi, këtë verë është bërë në rregull, ka problem të vogla, nuk kemi dëgjuar shumë shqetësime për këtë gjë. Dalim te pyetja tjetër te erozioni. Unë ndoshta dhe si pak më i dashur me këtë lloj teme kam folur me drejtorin e gjeologjisë detare, që është instancë që monitoron bregdetin edhe i kam shprehur shqetësimet duke i shikuar dhe nga ana studimore. Ata vetë e bëjnë anën studimore, varen nga Ministria e Infrastrukturës, merren vetëm me studime, por jo me anën e implementimeve për arsye se thotë nuk kemi buxhet. Nuk është edhe ne nuk advokojmë për ta mbajtur edhe me qenë edhe me gjet mënyrën e zgjidhjes, por nuk ka qenë e lehtë, thotë, dhe mënyra më mirë është se si presim që të bëjmë një studim të mirë dhe të presim që në momentin kur të vijë një organizëm ndërkombëtar t'i themi çfarë problemi dhe të gjejmë zgjidhje. Edhe ata thonë që kanë buxhet vetëm për studime, por jo për implementime, kështu që nuk është se nuk e hedhim në fushën tonë të punës që me gjetë zgjidhje. Këto ishin, kurse punën e zjarreve, e përmenda përpara, drejtoria e zjarrfikëses, është instaluar në Shëngjin me inspektorët e saj, bëjnë edhe sinjalizim të shpejtë, tash edhe me anën dixhitale ne jemi përherë në krye se edhe janë krijuar dhe mekanizma se si me i monitoru për një sinjalizim të shpejtë. Ishalla s'kena probleme. Sipas një takimi me emergjencat civile para dy tre ditësh ku ishte dhe nënkryetari edhe nënkryetarja është në dijeni, ka pasë procedime penale në gjendje të lirë për të dyshuarit dhe policia po merr studimet për të vazhduar. Faleminderit, këto ishin.

-Agostin Marku: Faleminderit. Kjo ishte për sa i përket rendit të ditës. Kush ka diçka të veçantë tjetër? Flutura ka fjalën.

-Flutura Gjoni: A ka ndonjë iniciativë, nuk di si t'ia vë emrin, dhe kjo është nismë për t'u përshëndetur, kjo e plazheve publike, po dhe te privati me vu një çmim tavan. A ka ndonjë mundësi?

-Renaldo Xhanej: Shiko, me të thënë të drejtën, ne kryejmë fushata ndërgjegjësuese. Kemi bërë disa grupe që si me i ul çmimet, por jemi në ekonominë e tregut të lirë edhe nuk mundemi krejt me i vu një target. Por ne kryejmë fushata ndërgjegjësuese që ta shikojmë afatgjatë, jo afatshkurtër, kështu që do

mundohemi sa më shumë që sa më afatgjatë ta kemi turizmin dhe të bëjmë fushata që të jenë sa më të ulëta çmimet.

-Agostin Marku: Tjetër, shiko, vetëm një ndërhyrje, vetë fakti që bashkia ka atë nivel çmimesh duke rritur cilësinë e shërbimeve, e detyron edhe pjesën tjetër që të rivlerësojnë çështjen e çmimeve. Po, kush ka tjetër? Donika.

-Donika Haxhia: Unë thjesht do të ritheksoj problemin e energjisë elektrike, që ju si përfaqësuesit e zgjedhur të këtij komuniteti të ndërmjetësoni me strukturat përkatëse të OSHEE-së për një rregullim të këtij problemi që është shumë madhor për Lezhën dhe kjo jo vetëm në kuadrin e turizmit, por edhe në kuadrin e ne qytetarëve apo vdekëtarëve normalë, jo banorë të Olimpiti, që duam të jetojmë, që të ngrihemi ditën e diel që jemi pushim dhe zgjohemi pa drita në korrik. Kaq kisha.

-Agostin Marku: Kush e do fjalën? Për sa i përket shqetësimit që e ngriti këshilltarja Donika Haxhia, po zoti zëvendëskryetar.

-Fatjon Zefi: A bëhet fjalë për një zonë konkrete?

-Donika Haxhia: Ishulli, edhe Zejmeni.

-Fatjon Zefi: Sepse në këto rastet e zjarreve, sapo të bjerë një zjarr afër gabinave, afër transformatorëve, stakohen vetë nga nënstacioni. Para një jave është djegur transformatori i madh te nënstacioni që ka vonuar 15 orë sa ka ardhur nga Tirana transformatori i ri, që ka bllokuar deri në Fushkuqe, jo vetëm Ishullin, ka qenë komplet zona.

-Agostin Marku: Tjetër? Zoti Pjetër.

-Pjetër Noka: Përshëndetje. A mundet me i vu dy llampa që janë djegur ka gjashtë muaj, te lagja përtej urës së Drinit.

-Agostin Marku: Merret në konsideratë nga drejtoria e shërbimeve. Fatjon është shqetësim.

Tjetër? Ju falënderoj shumë për gjithë kontributin që dhatë edhe për produktivitetin e kësaj mbledhjeje duke miratuar një sërë vendimesh shumë cilësore. Faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Florida Cunaj
8

ZV/KRYETARI

Agostin Marku
Cunaj